

### 1.1 Teknologji që ruajnë ose aksesojnë të dhëna në pajisjen tuaj

Ne përdorim teknologji të caktuara (p.sh., SDK, API, etj.; nga këtu e tutje: “Teknologji”) që janë mjete të siguruara nga prodhuesi i një platforme, sistemi operativ ose gjuhë programimi për qëllime të ndryshme. Ne përdorim teknologji të tilla vetëm për qëllime të nevojshme teknike ose për t'ua bërë më të lehtë përdorimin e aplikacionit tonë në pajisjen tuaj.

Jeni të lirë të bëni zgjedhjet tuaja dhe të lejoni ose refuzoni përdorimin e Teknologjive që ruajnë ose aksesojnë të dhëna në pajisjen tuaj. Ju lutemi të vini re se disa veçori dhe funksione të caktuara të aplikacionit kanë nevojë për këto Teknologji, ndaj ato mund të mos punojnë siç duhet nëse nuk lejohet përdorimi i këtyre Teknologjive.

Ju mund ta refuzoni përdorimin e këtyre Teknologjive duke ndryshuar zgjedhjet tuaja në aplikacionin tonë.

**1.2.1 Teknologjitë e domosdoshme:** këto Teknologji ruajnë ose aksesojnë të dhëna në pajisjen tuaj, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e aplikacionit tonë: pa këto Teknologji të domosdoshme, aplikacioni nuk do të punojë aspak ose nuk do të punojë siç duhet, ndaj këto Teknologji janë të nevojshme për të përdorur aplikacionin tonë në pajisjen tuaj.

Këto Teknologji nuk mund të çaktivizohen. Nëse i bllokoni këto Teknologji si përdorues, aplikacioni ynë nuk do të funksionojë siç duhet. Ne i përdorim Teknologjitë në përputhje me nenin 6(1)(f) të GDPR, dhe seksionin 13/A(3) të Ligjit CVIII të vitit 2001 për tregtinë elektronike, me qëllim që t'ju ofrojmë shërbimin.

Ne përdorim Teknologjitë e domosdoshme të mëposhtme:

Emri	Të dhëna	Qëllimi	Kategoria e Teknologjisë	Periudha e ruajtjes së të dhënave
<b>Firebase RemoteConfig SDK</b>	Të dhëna për llojin e pajisjes së përdoruesit, sistemin operativ të pajisjes	Qëllimi i kësaj Teknologjie është që të ndryshohet sjellja dhe pamja e aplikacionit pa qenë nevoja për të publikuar një përditësim.	Pala e tretë	1 muaj

**1.2.2 Teknologjitë e performancës:** këto Teknologji u referohen mjeteve të përdorura në mënyrë specifike për monitorimin e performancës së aplikacionit, mbledhjen e të dhënave për mënyrën se si vizitorët e përdorin aplikacionin, cilat pjesë përdorin ata dhe nëse marrin apo jo ndonjë mesazh gabimi. Ne përdorim Teknologji të performancës mbi bazën e aprovimit tuaj, në përputhje me GDPR nenin 6(1) dhe seksionin 13/A(4) të Ligjit CVIII të vitit 2001 për tregtinë elektronike. Mund ta tërhiqni aprovimin tuaj në çfarëdo kohe. Tërheqja e miratimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit në bazë të miratimit përpara tërheqjes së tij.

Ne përdorim Cookies të performancës të mëposhtme:

Emri	Të dhëna	Qëllimi	Kategoria e Teknologjisë	Periudha e ruajtjes së të dhënave
<b>Firebase Crashlytics SDK</b>	Lloji i pajisjes së përdoruesit, versioni i iOS, të dhënat e crash-it	Kjo teknologji është një raportuar crash-i në kohë reale që na ndihmon të ndjekim, t'u japim prioritet dhe të rregullojmë problemet e stabilitetit	Pala e tretë	12 orë

		që dëmtojnë cilësinë e aplikacionit.		
<b>Firebase Perf SDK</b>	Të dhënat e performancës	Qëllimi i kësaj Teknologjie na ndihmon të marrim njohuri për karakteristikat e performancës së aplikacionit tonë.	Pala e tretë	12 orë
<b>FirebaseAnalytics SDK</b>	Aktiviteti i përdoruesit, lloji i pajisjes, versioni i aplikacionit, versioni i OS	Qëllimi i kësaj Teknologjie është që të na ndihmojë të kuptojmë mënyrën se si e përdorni aplikacionin tonë.	Pala e tretë	1 vit
<b>Google Analytics SDK</b>	Aktiviteti i përdoruesit, lloji i pajisjes, versioni i aplikacionit, versioni i OS	Qëllimi i kësaj Teknologjie është që të na ndihmojë të kuptojmë mënyrën se si e përdorni aplikacionin tonë.	Pala e tretë	1 vit

**1.2.3 Teknologjitë shënjestruese:** ne përdorim Teknologji shënjestruese për të mbledhur informacion rreth jush dhe nga pajisja juaj për t'ju ofruar eksperiencë më të personalizuar me aplikacionin tonë dhe për t'ju shfaqur reklama më të personalizuar sipas preferencave tuaja dhe për të matur analitikën e aplikacionit. Baza ligjore e përpunimit të të dhënave është aprovimi juaj i bazuar në GDPR neni 6(1)(a) dhe seksionin 13/A(4) të ligjit CVIII të vitit 2001 për tregtinë elektronike. Mund ta tërhiqni aprovimin tuaj në çfarëdo kohe. Tërheqja e miratimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit në bazë të miratimit përpara tërheqjes së tij.

Ne përdorim Teknologjitë shënjestruese të mëposhtme:

Emri	Të dhëna	Qëllimi	Kategoria e Teknologjisë	Periudha e ruajtjes së të dhënave
<b>GoogleMobileAds SDK</b>	Preferencat e përdoruesit	Qëllimi i kësaj teknologjie është që të na japë mundësi t'ju shfaqim reklama në aplikacionin tonë.	Pala e tretë	1 vit

**1.2.4 Teknologjitë funksionale:** ne i përdorim këto Teknologji për t'i dhënë mundësi aplikacionit tonë që t'ju dërgojë mesazhe, njoftime dhe për t'ju ofruar shërbime praktike. Ne mund t'i përdorim këto Teknologji funksionale mbi bazën e aprovimit tuaj në përputhje me GDPR neni 6(1)(a) dhe seksionin 13/A(4) të ligjit CVIII të vitit 2001 për tregtinë elektronike.

Ne përdorim Teknologjitë funksionale të mëposhtme:

Emri	Të dhëna	Qëllimi	Kategoria e Teknologjisë	Periudha e ruajtjes së të dhënave
<b>Airship SDK</b>	Përfshirje direkte (klikime), sesion, evente të personalizuara, cookies të shfletuesit, atributet,	Qëllimi i kësaj Teknologjie është që t'ju dërgojë njoftime dhe të mbledhë të dhëna nga pajisja juaj.	Pala e tretë	1 vit

	etiketa, përdoruesi i emëruar, regjistrimi, refuzimi			
<b>Firestore Messaging Android SDK</b>	Adresa e email-it, numri i telefonit celular	Kjo Teknologji na jep mundësi t'ju dërgojmë njoftime dhe mesazhe.	Pala e tretë	1 vit
<b>Cartrawler Mobility SDK</b>	Shteti, të dhënat e vendndodhjes, të dhënat e udhëtimit	Kjo Teknologji na jep mundësi të ofrojmë mundësi të reja transporti tokësor brenda aplikacionit tonë.	Pala e tretë	1 vit
<b>Regula SDK</b>	Pamjet, të dhënat e dokumenteve për identifikimin e përdoruesit	Qëllimi i kësaj Teknologjie është të na japë mundësi të lexojmë lloje të ndryshme të dokumenteve të identifikimit, pasaportave, kartave të identitetit, etj. I gjithë përpunimi kryhet krejtësisht offline në pajisjen tuaj.	Pala e tretë	1 vit
<b>DGC SDK</b>	Të dhënat lidhur me certifikatën digjitale për covid	Qëllimi i kësaj Teknologjie është të integrojë informacion lidhur me certifikatën tuaj për COVID-19 në aplikacionin tonë.	Pala e tretë	1 vit
<b>Google Play Services Measurement SDK</b>	Aktiviteti i përdoruesit, lloji i pajisjes, versioni i aplikacionit, versioni i OS	Qëllimi i kësaj Teknologjie është që të ofrojë të dhëna të analitikës së aplikacionit për të përmirësuar shërbimet tona.	Pala e tretë	1 vit
<b>PayCardsRecognizer SDK</b>	Të dhënat e përdoruesit, të dhënat e kartës së kreditit	Qëllimi i kësaj Teknologjie është sigurojë funksionin e integruar të skanimit të kartës së kreditit.	Pala e tretë	1 vit

1.3 Për informacion të mëtejshëm lidhur me Teknologjitë që përdoren në aplikacionin tonë, ju lutemi të na kontaktoni në detajet tona të kontaktit elektronik në <https://wizzair.com/sq-al/informacioni-dhe-sherbimet/kontakti/na-kontakti>